



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI

Nr. 3486/prot

Koplik më: 01/09 / 2022

V E N D I M

Nr 37 datë 31 / 08 / 2022

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 31.08.2022, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015."Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 112/2013" Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë" seksioni 3 neni 14, neni 15 pika 1/a, pika 2/b, neni 16/1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

V E N D O S I

1. T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi" **Z. Pjeter Smakaj (pas vdekjes)** me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si arsimtarë dhe drejtues i dalluar në shumë shkolla dhe institucione arsimore, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 31.08.2022

Vota Pro 21

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 01.09.2022





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 2456 prot

Koplik më: 30/08/2022

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Pjetër Smakaj (pas vdekjes)



Pjetër Smakaj lindi me 13.9.1946 në QytetinKoplik, Bashkia Malësi e Madhe. Arsimin fillorë e më pas e ka mbaruar në vendlindjen e tij. Ka mbarua Arsimin e Lartë në Shkoder Dega histori-gjeografi ne vitin 1977. Nga viti1970-1972 ka punuar mësues në fshatin Kamicë. Ka filluar punën mësues që në vitin 1967 në Zonën e Dukagjinit e më pas për 10 vite ka qënë Drejtor i Shkollës Xhaj të Shkrelit e më pas për 5 vite Drejtor i Shkollës Dedaj po në Shkrel. Në vitin 1998 ka filluar punë Drejtor I Drejtorisë Arsimore Malësi e Madhe pozicion të cilin e ka mbajtur deri nëvetin 2003. Nga viti 2003 e deri në vitin 2005 ka punuar Drejtor I qendrës Kulturore të Fëmijëve M.Madhe. Më pas deri në vitin 2008 I është rikthyer profesionit të nderuar të mësuesit deri në vitin 2008 kohë kur ka dale në pension. Gjithashtu i ndjeri Pjetër Smakaj ka qënë për disa vite edhe Anëtarë i Këshillit Bashkiak Koplik. Vdiq me 27 Mars 2019 duke lënë pas një punë e përvojë të dalluar në shërbim të arsimit të trevës tonë.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e Madhe me
motivacion:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si arsimtarë dhe drejtues i dalluar në shumë shkolla dhe institucione arsimore, duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe".

